



Përmbajtja e Raportit:

Hyrje .....	faqe 2
1. Kuadri ligjor .....	faqe 3
2. Ndërgjegjësimi .....	faqe 7
3. Masat ekzekutive të ndërmarra .....	faqe 12
4. Përfshirja në aktivitete Ndërkombëtare .....	faqe 21
5. Trajnimi i stafit të Komisionerit .....	faqe 24
6. Strategjia për vitin 2010 .....	faqe 29
7. Mbështetja Ekonomike – Financiare .....	faqe 30



## RAPORT VJETOR

### I

#### KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Për të siguruar zbatimin efikas të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Institucioni i Komisionerit ka kryer një sërë veprimtarish të rëndësishme gjatë vitit 2009. Nga ana e Institucionit tonë është parë si detyrë parësore zhvillimi profesional i stafit të zyrës, vazhdimi i rritjes së ndërgjegjësimit të shtetasve mbi të drejtën e privatësisë si dhe kërkesa ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë në përpunimin dhe kontrollin e të dhënave personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës së tyre në përputhje të plotë me legjislacionin në këtë fushë.

Si një institucion i sapo krijuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka pasur si qëllim që gjatë punës së tij të implementojë eksperiencat më të mira ndërkombëtare në mënyrë që në një kohë sa më të shkurtër të arrijë në nivelin e Institucioneve homologe perëndimore.

Stafi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është angazhuar dhe ka konsideruar si një aspekt tjetër të rëndësishëm për organizimin dhe funksionimin e institucionit, plotësimin e kuadrit ligjor duke hartuar një sërë Aktesh ligjore në përputhje me aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke realizuar kështu një nga objektivat tona kryesore, përafrimin e legjislacionit me atë komunitar.



## 1. Kuadri Ligjor

Sa i përket **kuadrit ligjor**, është parë si domosdoshmëri hartimi i akteve nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në zbatim të ligjit dhe në dobi të punës së të gjithë kontrolluesve.

Përmendim;

### 1.1 Vendimet e Këshillit të Ministrave

- Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 mbi "Mbrojtjen e të Dhënave Personale" ka hartuar projekt-vendimin "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave", akt ky tashmë i miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 934, datë 02.09.2009. Në këtë Vendim janë parashikuar si Shtete me nivel të mjaftueshëm: Shtetet anëtare të BE, Shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane, Shtetet anëtare që kanë ratifikuar konventën Nr. 108 të vitit 1981 "Për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale" dhe protokollin e saj shtesë, që garantojnë mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave personale, në përputhje me të gjitha kërkesat e direktivës 95/46/EC, të Parlamentit dhe Këshillit European, datë 24 tetor 1995. Në vendim janë parashikuar edhe shtetet, në të cilët mund të transferohen të dhënat personale, sipas vendimit të Komisionit të BE. Aktualisht listimi i detajuar i shteteve është publikuar në faqen zyrtare të institucionit duke lehtësuar kështu punën e kontrolluesve gjatë transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.
- Këshilli i Ministrave me propozim të institucionit tonë ka miratuar Vendimin Nr. 1232, datë 11.12.2009, "Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale, që përpunohen" detyrim ky i parashikuar nga pika 4 e nenit 21 të Ligjit. Në të janë përcaktuar rastet: - kur përpunimi i të dhënave kryhet nga organizatat jofitimprurëse politike, sindikaliste, fetare ose filozofike, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme; - kur përpunimi lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik dhe privat, në ushtrimin e



të drejtave e të detyrimeve të parashikuara në akte, ligjore dhe nënligjore të kufizuar në qëllimin e pranimit; kërkesat; konkurse; emërimet, ngritjen në detyrë, rezultatet e vlerësimeve të punës, masat disiplinore; regjistrin e personelit, kualifikimit, të dhënave në punën e kontratës dhe vlerësim të pagave. Ky vendim më tej përjashton përpunimin e të dhënave në pajtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", por që kufizohet në përmbushjen e qëllimeve të nevojshme, në përputhje me Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

## 1.2 Përgatitja e Akteve administrative të Institucionit të Komisionerit (hartuar e miratuar nga Komisioneri)

- Me qëllim ecurinë dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit me urdhërin nr 48, datë 30.07.2009 është miratuar Rregullorja e Brendshme. Në këtë dokument përcaktohet në mënyrë të hollësishme gjithë veprimtaria e brendshme e Institucionit për organizimin, funksionimin e strukturave të tij, disiplinën e brendshme në institucion, si dhe drejtimin e administrimin e përditshëm të veprimtarisë së tij. Miratimit të rregullores i është bashkëngjitur edhe hartimi i standarteve të shkresave të ndryshme të institucionit.
- Gjithashtu, me Urdhërin nr. 49, datë 31.07.2009 është miratuar Kodi i Etikës së institucionit. Në këtë Kod përcaktohen rregullat e sjelljes së punonjësve të Autoritetit të Komisionerit gjatë kryerjes së detyrës dhe jashtë saj, sipas standarteve bashkëkohore bazuar në parimet e shtetit ligjor.
- Është përgatitur dhe miratuar dokumenti mbi Rregullat e "Administrimit të Shërbimit Civil të Zyrës së Komisionerit". Ky dokument është zbatuar në rekrutimin e stafit në këtë institucion.
- Janë hartuar e miratuar Rregullat "Për përcaktimin e kriterëve të veçanta për vlerësimin e rezultateve të punës së punonjësve të këtij Autoriteti", bazuar në ligjin "Statusi i nëpunësit civil".



- Është përgatitur komentari (Zbërthim i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim njohje), si dokument bazë për publikimin dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe private si dhe ndërgjegjësimin e publikut për të vënë në lëvizje Komisionerin për mbrojtjen e të dhënave personale në rast shkeljesh të kërkesave të ligjit nga marrësit dhe përpunuesit e të dhënave personale, institucione shtetërore e private, që ligji i quan Kontrollues e Përpunues. Ky dokument i është dërguar për njohje të gjithë institucioneve më të rëndësishme.
- Me Urdhërin Nr.66 datë 01.10.2009 është miratuar “Formulari i Njoftimit”, si dhe “Udhëzuesi për Plotësimin e Formularit të Njoftimit”. Njoftimi i kontrolluesve është një detyrim që rrjedh nga nenet 21 dhe 22 të Ligjit “Për Mbrojtjen e të dhënave Personale”.
- Me Urdhërin 67, datë 02.10.2009 janë miratuar aktet në zbatim të veprimtarisë së punës së Drejtorisë së Hetim-Inspektimi në të cilat përfshihen: Formulari i ankimit, Urdhëri për kryerjen e hetimeve administrative, Procesverbali i hetimit administrativ si dhe Vendimi përfundimtar. Eksperiencat e marra kanë ndihmuar në hartimin e këtyre akteve për të ndjekur shkresërisht ankimin e ardhur, kqyrjen në vend sipas rastit të paraqitur, kryerjen e hetimit kur nevojitet si dhe masat e marra e vendosjen e sanksioneve nëse gjykohen e vlerësohen si të tilla nëpërmjet vendimit të marrë.
- Bazuar në Ligjin Nr 9367, datë 7.04.2006 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", është hartuar dhe miratuar me Urdhërin nr. 112 datë 24.12.2009 rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale".

### 1.3 Aktet administrative ligjore në proces përpunimi dhe miratimi nga Institucioni i Komisionerit

Vlen të përmendet se, që prej fundit të vitit 2009 e në vazhdim nëpërmjet urdhërave të brendshëm të nxjerrë për ngritjen e grupeve të punës për përgatitjen e një sërë aktesh të rëndësishëm në dobi të veprimtarisë së punës së kontrolluesve, detyrime që burojnë nga ligji ynë i posaçëm, po bëhet një punë e konsiderueshme e stafit, veprimtari kjo e cila do



të pasohet me miratimin dhe njohjen e tyre nga të gjithë kontrolluesit nëpërmjet takimeve bashkëpunuese si dhe nëpërmjet publikimit online. Për të arritur në akte të standarteve të larta prej shumë kohësh stafi është angazhuar në përkthime dhe analiza të materialeve të marra nga vende në të cilat janë zhvilluar vizita studimore e që kanë ekperiencat më të mira në fushën mbrojtjes së të dhënave personale. Këto materiale kanë shërbyer e po shërbejnë në punën studimore e hartuese për vetë faktin se në kushtet aktuale literatura jonë nuk plotëson tërësisht këtë kuadër pasi ende nuk kemi ekspertë të mirëfilltë vendas në këtë drejtim, e për rrjedhojë kërkimet tona do të vazhdojnë dhe sigurisht e ardhmja në këtë fushë delikate do të tregojë ndjeshmëri, do të kërkojë rregull, si dhe do të nxisë respektimin e kodeve të sjelljes.

Kështu;

Janë në proces hartimi, Vendime dhe Udhëzime të renditura si më poshtë:

- Vendim i Komisionerit “ Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave” bazuar në pikën 5 të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Vendim i Komisionerit “Për përcaktimin e procedurave të administrimit, të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe të nxjerrjes së tyre “ bazuar në pikën 6 të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Udhëzim i Komisionerit “ Për veprime të kontrolluesve përpara fillimit të përpunimit të të dhënave personale” bazuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Udhëzim për Kontrolluesit “ Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e sektorëve të veçantë” bazuar në shkronjën “f” të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe,
- Udhëzim “Për përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale, sipas qëllimit të tyre në veprimtarinë e sektorëve të veçantë” bazuar në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 31 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.



## 2. Ndërgjegjësimi

### 2.1 Seminare dhe Trajnime

Në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave, nga ana e Komisionerit gjatë vitit 2009 janë organizuar një numër i gjerë veprimtarish për zbatimin e Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe funksionimin me efikasitet të këtij Institucioni.

Në janar të vitit 2009, titullari i Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në një aktivitet të kryesuar nga Zv. Kryeministri, me pjesëmarrjen e drejtuesve kryesorë të Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale e Shanceve të Barabarta, Ministrisë së Arsimit, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, etj. Ky aktivitet konsistonte në implementimin e Programit (vënien në punë të instrumentit) elektronik të shkëmbimit e të transmetimit të ndërsjellë për nevoja të tyre, të të dhënave personale në zbatim të kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në datë 4 Shkurt 2009, Këshilli i Evropës (KE) dhe Institucioni ynë organizuan një konferencë për Mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri. Konferenca shërbeu për prezantimin e Institucionit të ri të pavarur, përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave në Shqipëri. Të pranishëm në këtë konferencë ishin Zv.Kryeministri, Ministri i Drejtësisë, Zv.Ministri i Brendshëm, krerët e Institucioneve publike në Shqipëri si dhe përfaqësues të trupit diplomatik në Shqipëri.

Në kuadrin e një fushate intensive sensibilizuese me institucionet publike, Institucioni i Komisionerit në datat 8-9 Korrik 2009 organizoi seminar në qytetin e Shkodrës me temë “*Njohje me ligjin dhe autoritetin mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale nga Kontrollues e Përpunues publik*”. Në këtë seminar morën pjesë nëpunës të Prefekturës, Gjendjes Civile, Drejtorisë Arsimore, Sektorit të Shëndetësisë dhe Policisë si dhe ekspertë ndërkombëtarë të fushës dhe përfaqësues të OSBE.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të kontrolluesve për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në zbatim të Ligjit Nr.9887, në datat 24-25 Shtator 2009 u zhvilluan seminare në qytetet e Gjirokastrës dhe Sarandës. Në këto seminare morën pjesë nëpunës të Bashkisë,



Prefekturës, Drejtorisë Arsimore, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë, Drejtorisë Tatimore Rajonale, Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor, Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, Universitetit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Sektorit Bankar.

Po ashtu, në datat 14-15 Tetor 2009 nga ana e stafit tonë u organizuan seminare në qytetet e Korçës dhe Pogradecit. Në këto seminare morën pjesë kontrollues kryesorë nga sektori publik dhe ai privat. Ky takim pati si qëllim ndërgjegjësimin e kontrolluesve lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre në zbatim të Ligjit “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”.

Në datë 18 Nëntor 2009 organizimi i seminarëve përfshiu sektorin bankar si një ndër kontrolluesit dhe përpunuesit kryesorë të të dhënave personale. Qëllimi i këtij seminari ishte njohja me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe detyrimi i subjekteve kontrollues për të njoftuar në lidhje me të dhënat që ato përpunojnë.

Në fundin e vitit 2009 stafi i institucionit tonë vlerësoi që të zhvillonte një seminar në Tiranë me Kontrollues privat, duke përfshirë këtu qendrat e mëdha tregtare, kompanitë e telefonise celulare, sektorin e telekomunikacionit, sektorin shëndetësor etj.

Duhet theksuar se në qendër të këtyre organizimeve kanë qenë referimi i temave më të rëndësishme mbi njohjen me ligjin dhe detyrimet e parashikuara në të për tu zbatuar nga të gjithë subjektet e përfshira në ligj, disa prej të cilave janë referuar edhe nga eksperti i KE i cili asistoi për disa muaj stafin e institucionit tonë si dhe pajisja e pjesëmarrësve me materiale ndërgjegjësuëse. Gjithashtu, vlen të përmendet interesimi i pjesëmarrësve në drejtim të detyrimeve ligjore që ligji parashikon për ta, zgjidhjet që pikërisht ky ligj ofron e sjell si risi, pyetjet e shumta, diskutimet e ndryshme, kërkesat për takime të vazhdueshme bashkëpunuese, etj.

## 2.2 Publikime dhe shpërndarja e broshurave

Siç përmendëm më sipër, në funksion të të gjithë aktiviteteve të zhvilluara, fushata e gjërë sensibilizuese është karakterizuar edhe nga shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuëse. Për hartimin dhe botimin e këtyre broshurave e fletëpalosjeve stafi ynë





ka treguar impenjim maksimal. Gjithashtu, duhet përmendur se, në botimin e disa prej të këtyre materialeve ndërgjegjësuese ka dhënë ndihmesë të konsiderueshme edhe OSBE.

Më konkretisht;

Fillimisht u hartua dhe u botua broshura, “*Njihuni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me zyrën e komisionerit*”, me qëllim ndërgjegjësimin e subjekteve të të dhënave personale për njohjen e të drejtave të tyre në përpunimin e të dhënave personale nga Kontrolluesit, duke përcaktuar gjithashtu ç’janë të dhënat personale, cilët janë marrësit e tyre dhe rregullat që ata duhet të zbatojnë në përpunimin e të dhënave. Në këtë broshurë është paraqitur dhe një formular për formën e përmbajtjen e ankimit.

Është përgatitur Fletëpalosje e veçantë për të rinjtë lidhur me përdorimin e “Rrjeteve sociale” online si dhe dhënia e disa këshillave mbi mbrojtjen e privatësisë. Pikërisht, për këtë grupmoshë delikate dhe mjaft të vlerësuar për të ardhmen duke qenë më e rrezikuara nga përdorimi i gjerë e pafund i teknologjisë së informacionit pa ditur e njohur pasojat e ardhura nga të dhënat që japin e shkëmbejnë përmes komunikimit online, në muajin Nëntor u ndërmorr një fushatë takimesh me studentë të disa fakulteteve e konkretisht nëpërmjet bashkëpunimit të dekanatit “Histori Filologji”, në katedrat “Histori”, “Gjeografi”, “Gjuhë Letërsi” dhe “Gazetari” u mundësua zhvillimi i disa orëve leksion duke referuar e mbajtur tema nga punonjës të stafit tonë, kryesisht mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, mbi të drejtën dhe mbrojtjen e privatësisë. Nga studentët e gazetarisë pati diskutime të shumta dhe u shfaq interes i veçantë në drejtim të përpunimit të të dhënave personale në fushën e medias, në televizion, film, radio, etj. Diskutime të gjera u zhvilluan edhe në fushën e teknologjisë së informacionit. Gjithashtu, në këto bashkëbisedime u shpërndanë edhe materiale ndërgjegjësuese, kryesisht kjo fletëpalosje, si dhe iu komunikua të rinjve se për të gjitha rastet e rrezikuara të mos ngurrojnë në kontaktimin me autoritetin tonë.

Në bashkëpunim me OSBE është përgatitur një fletëpalosje, në përmbajtje të së cilës është synuar të shpjegohet lehtësisht se, cilat janë të dhënat personale, kush i merr e përpunon ato dhe mënyrën e vënies në lëvizje të Komisionerit në rast shkelje të rregullave të përpunimit nga institucionet shtetërore e private.

Po ashtu, pas takimeve sensibilizuese të zhvilluara me sektorin bankar u ndje nevoja e përgatitjes dhe botimit të fletëpalosjes “*Banking online, siguroni identitetin tuaj financiar*”.



Është përgatitur edhe një Fletëpalosje mjaft e vlerësuar e cila i përket pikërisht orientimit të subjekteve drejt "*Kontaktit me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".

Sensibilizimi të cilit institucioni ynë i kushtoi një rëndësi të veçantë në vitin e parë të funksionimit të tij u realizua edhe në një tjetër mënyrë të thjeshtë duke tentuar paisjen me materiale ndërgjegjësuese në ambiente të hapura të kryeqytetit nëpërmjet një stende lëvizëse informuese, kryesisht nëpër fakultete, librari, qendra tregtare, pasi edhe fluksi i subjekteve të të dhënave relativisht konsiderohet i madh.

Këto aktivitete orientojnë tashmë qartazi institucionin tonë drejt investigimit të implementimit të ligjit dhe sigurisht drejt evidentimit të mangësive me qëllim dhënien e rekomandimeve apo dhe vendosjen e sanksioneve ligjore, kompetencë e këtij autoriteti.

Po ashtu, me qëllim pasqyrimin dhe mundësinë e kontaktimit të Zyrës së Komisionerit në Internet, është krijuar faqja zyrtare e institucionit tonë. Adresa e faqes është [www.kmdp.al](http://www.kmdp.al) dhe me host në një kompani private amerikane. Faqja është e paraqitur në mënyrë të thjeshtë duke pasur një strukturim nëpërmjet menuve dhe nënmenuve. Janë pasqyruar në të informacionet e përgjithshme mbi Zyrën e Komisionerit, ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale por edhe ligje të tjera ndihmëse. Këto ligje janë të gjitha në versione të shkarkueshme. Gjithashtu janë pasqyruar informacione rreth regjistrimit të njoftimeve por edhe mbi aktivitetet e institucionit tonë dhe materialeve të përgatitura nga stafi. Ka dhe linke që lejojnë lidhjen me institucionet homologe Evropiane dhe botërore si dhe me institucionet qendrore Shqiptare. Në linkun e kontaktit krijohet mundësia e informacionit rreth adresës së institucionit dhe mënyrës së kontaktit elektronik, për informacione shtesë por edhe për ankesa të ndryshme. Faqja përditësohet, kontrollohet dhe mirëmbahet nga sektori i TI-së.

Gjithashtu, është krijuar shërbimi i e-mailit zyrtar ekskluzivisht për punonjësit e Zyrës së Komisionerit. Ai është i adresuar me përmbajtje emër mbiemër dhe me adresën zyrtare të faqes së internetit, pra [emër.mbiemër@kmdp.al](mailto:emër.mbiemër@kmdp.al). Ky shërbim ofron vetëmenaxhim dhe një ndërfaqe lidhjesh të koordinuara midis adresave brenda institucionit. Ai menaxhohet dhe mirëmbahet nga sektori IT.

Duke marrë në konsideratë qëllimin dhe përfaqësimin e Komisionerit, u punua në lidhje me logon e institucionit. Për krijimin e logos u kërkua edhe ndihmë nga specialistë jashtë institucionit. U vlerësuan ngjyrat që do të përdoren dhe simbolika. Si simbolikë u



përdorën gërmat *C-Commissioner*, *D-Data*, *P-Protection*. Gërmat *DP*, në të cilën gërma P-protection (mbrojtje) ndërthuret me germën *D-data (të dhëna)* për të dhënë mesazhin që, “*të dhënat personale duhen mbrojtur*”, e gjitha kjo e përfshirë në brendësi të gërmës *C-Commissioner*, autoritet i cili mbron dhe kontrollon perpunimin e të dhënave personale nga përpunuesit/kontrolluesit publikë ose privatë.

Ngjyrat, e kuqe dhe e zezë të germave *DP (data protection)*, simbolizojnë ngjyrat e flamurit Kombëtar, ndërsa ngjyra e kaltër e gërmës *C-Commissioner* simbolizon përqasjen dhe orientimin e Institucioneve Shqiptare në Institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian.

### 2.3 Aktivitete të tjera të rëndësishme

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të dhënave personale stafi i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave u angazhua në organizimin e një sërë aktivitete të cilat kulmuan në datën 28 janar. Evenimentet që u mbajtën përfshinë datat 25 deri 28 janar 2010.

Në datën 25 janar 2010 Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizoi një takim informues me administratorët e qendrës tregtare më të madhe në vend “City Park”. Në këtë takim u referuan tema në lidhje me njohjen e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, prezantimi i Autoritetit të Komisionerit, mbi detyrimet e kontrolluesve dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, sigurinë e informacionit, etj. Gjatë seminarit u projektuan dhe u shfaqën dy video sensibilizuese në lidhje me Temën e Privatësisë dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në fund të seminarit u shpërndanë fletëpalosje në lidhje me ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Detyrimin për Njoftim, Rrezikun nga përdorimi jo i rregullt i rrjeteve sociale, fletëpalosje “Siguroni identitetin tuaj financiar” (Banking online), “Ju vijmë në ndihmë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale”, “Si mund të përfitosh në kontakt me Zyrën e Komisionerit”, etj. Në datën 26 Janar, institucioni ynë organizoi një takim sensibilizues me studentët e Universitetit “Illyria”. Në këtë takim u referuan tema në lidhje me njohjen e ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sigurinë e informacionit si dhe njohja dhe siguria në rrjetet sociale,



etj. Gjatë këtij takimi studentët shfaqen një interes të veçantë dhe morrën pjesë aktive në diskutimin që vijoi rreth temës së Mbrojtjes së të Drejtave Personale.

Në datën 27 Janar, në bashkëpunim me “Sos Fshatrat e Shqipërisë, Shkolla Hermann Gmeiner” Zyra e Komisionerit organizoi një konkurs pikturë dhe ese-je me nxënësit e grupmohës 10 deri në 15 vjeç me temën “Mburo Privatësinë”. Rreth 40 nxënës pasqyruan krijimtarinë e tyre në pikturë dhe rreth 20 të tjerë realizuan ese dhe poezi të çmuara rreth temës së privatësisë.

Ekspozita me piktura u hap në mjediset e shkollës më datën 27 janar 2010, ditë në të cilën u ndanë dhe çmimet fituese si dhe ato inkurajuese për pikturën dhe ese-në më të bukur. Konkursi u ndoq edhe nga një spektakël i organizuar nga fëmijët e shkollës “Hermann Gmeiner”.

Më 28 janar 2010, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi me rastin e Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, një konferencë me pjesëmarrjen e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të tilla si Zyra e OSBE-së, Delegacionit të KE-së, Ministrit të Shtetit dhe subjekte të tjerë të interesuar. Fjalë përshëndetëse u mbajt nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministri i Shtetit, Përfaqësuesi i OSBE-së, Përfaqësuesi i Komisionit Evropian. Në konferencë, referoi edhe Z. Graham Sutton, ish/Ekspert këshillues për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pranë Këshillit të Evropës. Gjatë konferencës u shfaq dhe spoti televiziv që OSBE ka planifikuar të transmetojë në televizionet kombëtare për sa i përket sensibilizimit të qytetarëve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Në Konferencë u prezantua buletini vjetor për vitin 2009 si dhe strategjia institucionale për vitin 2010 e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **3. Masat ekzekutive të ndërmarra**

#### **3.1 Plotësimi i Detyrimit për Njoftim dhe Regjistrimi i Subjekteve Kontrolluese**

Ashtu sikurse e përmendëm më lart, në zbatim të dispozitave ligjore, me qëllim implementimin e tyre dhe rritjen e efikasitetit të zbatimit të kompetencave të Komisionerit, me Urdhërin Nr. 66 datë 01.10.2009 të Komisionerit është miratuar “Formulari i Njoftimit”, si dhe “Udhëzuesi për Plotësim e Formularit të Njoftimit”, për



kontrolluesin publik dhe privat, me qëllim plotësimin e detyrimit ligjor për njoftim-regjistrimin. Gjithashtu, pas hartimit të projekt-vendimit nga Zyra e Komisionerit dhe propozimit të Ministrit të Shtetit, në kuadrin e një mbështetje dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1232 datë 11.12.2009 “Për caktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale që përpunohen”, i cili përcakton rastet e mëtejshme për të cilat njoftimi për përpunimin e të dhënave pranë Komisionerit nuk është i nevojshëm.

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtyre akteve, procedurat e njoftimit dhe regjistrimit të subjekteve kontrolluese, në plotësim të detyrimit të parashikuar nga Neni 21 i Ligjit “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kanë filluar në Nëntor të vitit 2009. Zyra e Komisionerit ka filluar të marrë njoftime për përpunimin e të dhënave nga subjekte kontrollues që i përkasin sektorit bankar, telekomunikacionit, sigurimeve shëndetësore, arsimit, institucioneve shëndetësore dhe biznesit privat. Ky fluks njoftimesh ka ardhur si pasojë jo vetëm i organizimit të aktiviteteve dhe seminareve ndërgjegjësuese për kontrollues të sektorëve përkatës, si dhe bërjes publike dhe sqarimeve online për këtë detyrim, por edhe si pasojë e investimit direkt të Zyrës së Komisionerit, duke i dërguar shkresa zyrtare këtyre subjekteve për t’i bërë të njohur detyrimin që kanë në bazë të ligjit për të njoftuar e për tu regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit.

Në këtë kuadër, i janë dërguar subjekteve kontrollues 290 shkresa mbi detyrimin për njoftim, si dhe 65 shkresa rikujtuese. Si rezultat, deri më sot, pranë Zyrës së Komisionerit janë paraqitur 37 njoftime. Në kuadrin e shqyrtimit ligjor dhe plotësimin të informacionit të deklaruar nëpërmjet formularit të njoftimit, Zyra ka kërkuar plotësimin, saktësimin dhe sqarimin e informacionit të deklaruar nga 31 subjekte kontrollues nga të cilët 19 shkresa për informacion plotësues kanë mbërritur pranë Zyrës, pjesa tjetër është në proces. Institucioni i Komisionerit është në kontakt të vazhdueshëm me subjektet për t’i asistuar e orientuar për plotësimin e Formularit të Njoftimit, nëpërmjet takimeve të ndryshme pranë zyrave të subjekteve, pranë zyrave tona, si dhe duke ju vënë në dispozicion një numër telefoni ku mund të na drejtohen.

Për të patur një reagim maksimal, eficient dhe të moderuar të plotësimin të këtij detyrimi që kanë subjektet kontrollues, publike ose private, Zyra e Komisionerit është në një proces strategjik aktiv për të ndërgjegjësuar subjektet për përmbushjen e këtij detyrimi. Në këtë kuadër i jemi drejtuar Ministrit të Shtetit për t’ju komunikuar të gjithë ministrive të linjës dhe institucioneve në varësinë e tyre, të marrin në konsideratë kërkesën e



sanksionuar në ligj, për plotësimin e detyrimit për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale për të cilat janë përgjegjës.

Gjithashtu, i jemi drejtuar zyrtarisht për mbështetje dhe bashkëpunim institucional Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim që bizneset e reja që regjistrohen dhe ato në aktivitet të bëhen me dije për këtë detyrim. Sinjalet për vendosjen e një bashkëpunimi të konsoliduar janë tepër pozitive dhe kontributi i këtyre institucioneve do jetë esencial. Po ashtu, në sajë të kërkesave për bashkëpunim, presim një përgjigje pozitive edhe nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, si dhe nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, të cilët mund të vënë në lëvizje të gjithë personat fizik e juridik me të cilët lidhet aktiviteti i tyre.

Me qëllim realizimin sa më praktik të detyrimit që kanë të gjitha subjektet publike dhe private për të njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale për të cilat janë përgjegjës, me qëllim menaxhimin e informacionit të deklaruar nga këto subjekte, si dhe me qëllim publikimin e këtij informacioni online në faqen zyrtare të Komisionerit, është krijuar një program kompjuterik i cili i krijon mundësinë subjekteve kontrolluese të njoftojnë duke plotësuar online në faqen zyrtare Formularin e Njoftimit.

Ky program automatikisht transmeton Formularin e plotësuar në Zyrën e Komisionerit dhe më pas ky deklaram i nënshtrohet shqyrtimit ligjor, në qoftë se informacioni është i plotë ose plotësohet nga subjektet kontrolluese me kërkesë të Zyrës, si dhe nëse nuk vërehet ndonjë rrezik që cënon parimet e privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale, subjekti regjistrohet në Regjistrin e Subjekteve Kontrolluese dhe informacioni bëhet i hapur për tu njohur nga publiku. Në këtë mënyrë, sikurse e parashikon ligji për bërjen publike të këtij informacioni, do të realizohet transparencja ndaj publikut, si dhe individët do të dijnë si të ezaurojnë të drejtat e tyre të sanksionuara në Ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.



## Tabela Statistike

Objekti	Drejtuar	Nr. Total
Njohje me detyrimin për njoftim	Subjekteve kontrollues	<b>290</b>
Rikujtesë për detyrimin për njoftim	Subjekteve kontrollues	<b>65</b>
Njoftime	Zyrës së Komisionerit	<b>37</b>
Kërkesë për informacion plotësues	Subjekteve kontrollues	<b>31</b>
Informacion plotësues i ardhur	Zyrës së Komisionerit	<b>19</b>
Shkresa për bashkëpunim	Insitucioneve	<b>5</b>

### 3.2 Trajtimi i ankesave të marra nga subjektet

Gjatë vitit 2009 nga ana e Drejtorisë së Hetim Inspektimit janë trajtuar 18 kërkesa ankimore të subjekteve të të dhënave. Kërkesat ankimore drejtuar Zyrës së Komisionerit kanë qënë të natyrave të ndryshme, në adresë të kontrolluesve publikë dhe privatë, si Zyrat e Gjendjes Civile pranë Bashkisë dhe Qarkut Tiranë, Arkivi i Qarkut Tiranë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH), Zyra e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Tiranë, Qarkut Durrës, Kompanisë private Infra Trans-Projekt LTD, etj.

Gjithashtu, gjatë trajtimit të kërkesave ankimore nga drejtoria përkatëse, në zbatim të kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale janë kryer investigime në kontrollues publikë e privatë të vendit dhe konkretisht:

- Në Bashkinë e Tiranës;
- Në Njësinë Bashkiake nr.10 Tiranë;
- Në seksionin Administrativ të Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Tiranë;





- Në shkollën Teknike Ekonomike;
- Në OSSH;
- Në kontrolluesin privat kompaninë Infra Trans- Projekt LTD, vënë në lëvizje me kërkesë të një subjekti të dhënash personale, vlen të përmendet se gjatë inspektimit të kryer pranë kësaj kompanie mbi kërkesën ankimore të subjektit të të dhënave, pjesë e së cilës subjekti kishte qenë më parë (në cilësinë e punëmarrësit) u konstatua se nga ana e kontrolluesit në kundërshtim me ligjin mbahesh ende në faqen zyrtare të punës së shoqatës foto e subjektit ankues megjithë shkëputjen e marrëdhënieve të punës kohë më parë nga ana e subjektit ankues. Por reagimi i kontrolluesit gjatë inspektimit tonë ishte i menjëhershëm duke plotësuar kërkesën e subjektit dhe në të tilla kushte nuk lindi nevoja e nxjerrjes së urdhërit të Komisionerit për fshirjen e kësaj shkelje të konstatuar. Por sigurisht pas një fushate intensive sensibilizuese , ndërgjegjësuese me të gjithë aktorët e vendit, rezultatet e pritshme do të jenë të mëdha, ankimet do të jenë të drejtuara qartë dhe për zgjidhjen e tyre Komisioneri do të veprojë me të gjithë forcën e ligjit, nëpërmjet urdhërimeve, vendimeve, dhënies së sanksioneve, etj.
- Në Arkivin e Qarkut Tiranë, përsëri të iniciuar nga kërkesat ankimore që lidhen me gabime të të dhënave që përmban dokumenti i pronësisë nxjerrë nga Arkivi i qarkut Tiranë (Tetor 2009).

Në këto investigime janë mbajtur dokumentat ligjorë dhe janë dhënë rekomandimet e duhura për zbatimin nga kontrolluesit dhe përpunuesit të rregullave dhe kritereve për përpunimin e të dhënave personale, të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të gjitha kërkesat ankimore janë trajtuar me kthim përgjigje subjekteve të të dhënave, duke iu dhënë dhe këshillat/sugjerimet përkatëse.

Në të njëjtën kohë janë zhvilluar takime me disa kontrollues publikë e privatë si rezultat jo vetëm i ankesave të trajtuara nga institucioni ynë por edhe me iniciativën e këtij të fundit në kuadër të njohjes dhe zbatueshmërisë së Ligjit 9887 datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” për ti paraprirë kështu kontrolleve të parashikuara për vitin 2010. Takimet kanë pasur si qëllim përveç njohjes me ligjin edhe mënyrën e plotësimit të formularit për njoftim nga kontrolluesit. Pikërisht për një orientim e





shpjegim të saktë përveç inspektorëve në takime kanë marrë pjesë edhe specialistë të Drejtorisë së Rregjistrimit.

Takime të rëndësishme kemi vlerësuar;

- Me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, konkretisht me kreun e kësaj drejtorie, duke prezantuar ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe shkëmbyer mendime rreth këtij ligji (Maj 2009)
- Me kontrolluesin që operon në sektorin privat Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSSH, takim i cili u nxit nga një ankesë drejtuar Zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale “mbi keqpërdorimin e të dhënave personale që përmbanin faturat e energjisë elektrike”. (Qershor 2009).
- Me Drejtorinë e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Tiranë (Shtator 2009)
- Pranë kontrolluesit Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë, vënë në lëvizje nga kërkesa ankimore drejtuar Zyrës së Komisionerit (Tetor 2009)
- Me kontrolluesin ALB-Telekom.
- Me përpunuesin e të dhënave, kompaninë private “Aleat Safran grup-Sagem” .
- Me Drejtorinë e Përgjithshme të Trasportit Publik.
- Me Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore.
- Me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim - Taksave.
- Me Drejtorin e Policisë së Kufirit.
- Me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.



### 3.3 Ushtrimi i kompetencave të tjera ligjore dhe bashkëpunimi

- Dhënie e mendimeve për akte ligjore e nënligjore.

Si një nga detyrimet që buron nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 31 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (nëpërmjet Drejtorisë së Çështjeve Procedurale e Ligjore) ka dhënë sugjerimet dhe opinionet ligjore në përputhje me fushën e tij specifike mbi aktet e përcjella nga institucione të ndryshme publike e private.

Në përforcim të këtij detyrimi, institucioni ynë i është drejtuar edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave që në ushtrim të kompetencave ligjore që i njeh ligji “Për organizimin e funksionimin e Këshillit të Ministrave” të mundësojë sugjerimin ndaj institucioneve që, në të gjithë rastet e ndërmarrjes së nismave ligjore nga ana e tyre, t’i përcjellin ato paraprakisht për mendim pranë Komisionerit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” me qëllim harmonizimin dhe përputhshmërinë e projekt-akteve të propozuara me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Këtu theksojmë se, shoqërimi i projekt-akteve nga të gjithë institucionet edhe me mendimin ligjor lidhur me të dhënat personale nga zyra e Komisionerit, do të sillte si rezultat zhvillimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

Në vijim renditim mendimet e dhëna mbi këto akte:

- Mbi projektligjin “Për bazën e të dhënave shtetërore”. Në këtë projektligj institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dhënë opinionet dhe mendimet e tij ligjore duke qenë përfshirës në grupin e punës për draftimin e tij.
- Mbi projekt-vendimin “Marrëveshje mbi bashkëpunimin e Institucioneve të zbatimit të Ligjit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”, akt i paraqitur nga Ministria e Brendshme.
- Për projekt-vendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 824 datë 06.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit” të ndryshuar.



- Mbi projekt rregulloren e Zyrës Kombëtare të Europolit. Hartimi i rregullores dhe i Udhërrefyesit ndikojne ne zbatimin e ligjit per implementimin e plote te marrveshjes strategjike te bashkepunimit mes vendit tone dhe Europolit.
- Mbi kërkesën e Ministrisë së Brendshme, lidhur me transmetim e të dhënave personale të kërkuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Fier për një grup personash, për të cilët kjo e fundit kishte rregjistruar procedimin penal. Opinioni ligjor në këtë rast sugjeroi kontrolluesin dhënës të të dhënave personale për të bërë të mundur transmetimin e të dhënave të kërkuara nën masa sigurie në zbatim të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Mbi projektligjin “Për faljen”
- Mbi projektin e ISKSH “Për përdorimin e Numrit të Idendifikimit të Shtetasit dhe letërnjoftimit elektronik” të përgatitur nga ky institucion si dhe me zhvillimet për realizimin e tij në mënyrë tabelare.

*Në vazhdim të mendimeve të dhëna e kërkesave të ardhura për trajtim renditim:*

- Trajtimin e kërkesës për informacion ligjor të Kontrolluesit privat të filialit të Bankës greke “Emporiki”, mbi transferimin e të dhënave personale të klientëve të kësaj banke, në selinë qendrore të saj në Greqi.
- Mbështetur në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të ligjit për të drejtën e informimit të dokumenteve zyrtare, është trajtuar kërkesa e Ministrisë së Brendshme për lejimin e transmetimit të të dhënave personale të personave që kanë aplikuar për pasaporta tek një grup deputetësh.
- Trajtimin e kërkesës së paraqitur nga Studio ligjore “Boga” për t’u njohur gjërësisht me fushën e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.
- Mjaft institucione private, kryesisht banka kanë shfaqur interesim për institucionin dhe kanë kërkuar pajisje me publikime, pas korrespondencës tonë të parë me të gjithë kontrolluesit, qëllim i së cilës ishte plotësimi me ligjin e publikimet e ndryshme, për ti paraprirë takimeve të tjera. Në këto raste por edhe të tjera është bërë kujdes për plotësimin e këtyre kërkesave.
- Në kuadër të përgatitjes së “Plan veprimit në kuader të hartimit perfundimtar të raportit per dialogun e liberalizimit të vizave me Komisionin Evropian – Tetor



2009”, është paraqitur në mënyrë të përditësuar e gjithë veprimtaria e institucionit tonë pranë Ministrisë së Jashtme dhe është vazhduar ndjekja e këtij procesi në bashkëpunim të ngushtë me këtë Ministri. Kjo procedurë është ndjekur në mënyrë të rregullt nëpërmjet një punonjësi të caktuar për të mbajtur një raportim të rregullt javor. Finalizimi i raportimit të dorëzuar gjatë vitit 2009, u krye me zhvillimin e takimit në ambjentet e institucionit tonë me Ekspertin e dërguar të BE-së, të cilit iu raportua aktiviteti i Zyrës së Komisionerit, zbatimi i Ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Në fund të këtij takimi iu dorëzua raporti i përgatitur mbi gjithshka të kryer nga institucioni ynë gjatë vitit 2009 në kuadër të liberalizimit të vizave.

- Gjithashtu, grupi i punës për hartimin e planit dhe shqyrtimin e materialeve për plotësimin e pyetësorit për statusin e vendit kandidat, rakordoi punën me të gjithë institucionet “Lider” dhe ata “Bashkëpunues” dhe në afatet kohore të përcaktuara përfundoi një nga detyrimet më të rëndësishme për mbarë vendin tonë.
- Po ashtu theksojmë se, tashmë ka përfunduar pjesa bazë për Termat e Referencës së asistencës teknike në kuadër të projektit IPA 2009, zhvillim ky që i takon të ardhmes.
- Në zbatim të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ka filluar bashkëpunimi për hartimin e Kodeve të Etikës nga Institucionet (Kontrolluesit). Në këtë kuadër ka filluar bashkëpunimi i parë me KKRT për të dhënë ndihmë të kualifikuar lidhur me Kodin Etik të Gazetarit.
- Në datën 5 shkurt 2010 Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Institucionet me anë të këtij bashkëpunimi synojnë thjeshtimin në aplikimin e procedurave për zbatim të Ligjit Nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Ky bashkëpunim do të pasohet nga të tjerë bashkëpunime por gjithashtu do të kërkojë vëmendje të vecantë në drejtim të realizimit hap pas hapi të tyre.



#### 4. Përfshirja në aktivitete Ndërkombëtare

Në datat 2, 3 dhe 4 Shtator 2009, në Strasburg, Francë u mbajt mbledhja e radhës (e 25-ta) e “Komitetit Konsultativ mbi Konventën për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale” (T-PD) të Këshillit të Evropës. Për herë të parë, falë bashkëpunimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme për akreditimin e institucionit tonë në këtë organizëm, u bë e mundur pjesëmarrja e Komisionerit për Mbrojtjen e të dhënave Personale në Shqipëri, në cilësinë e anëtarit me të drejtë vote. Pjesëmarrja e institucionit tonë do të çojë në rritjen e efikasitetit të Zyrës së Komisionerit në zbatimin e detyrave dhe kompetencave ligjore, si dhe do të kontribuojë drejtëpërdrejtë në çështjet e trajtuara nga Këshilli i Evropës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Ky kontribut ishte i menjëhershëm duke dhënë kështu si fillim mendim ligjor për “Projekt - Rekomandim për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, në lidhje me profilizimin e individëve”, i cili pritet të finalizohet në takimin e ardhshëm plenar të këtij komiteti. Të tjerë opinione ligjore do të përfaqësojnë institucionin tonë në këtë komitet.

Me ftesë të KE në datat 22 dhe 23 Tetor 2009, Institucioni ynë u përfaqësua në Konferencën e vendeve Evropiane të Autoriteteve Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilluar në Qipro. Në këtë Konferencë morën pjesë 30 shtete të Evropës me përfaqësuesit e Autoriteteve të Mbrojtjes së të dhënave personale, të këtyre vendeve. Në këtë aktivitet u mbajtën rreth 20 (njëzet) tema të ndryshme të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale si; rreziqet nga interneti, fushat e sensibilizimit të fëmijëve, mbikëqyrja kibernetike, përdorimi i të dhënave biometrike, të dhënat sensitive, aksesit në sistemin bankar, aksesit në dosjet mjekësore, mbikëqyrja me kamera, etj.

Temat e sipërpërmendura ishin mjaft të vlefshme dhe përfaqësuesit tanë përfituan eksperiencën e vendeve me nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale, si në drejtim të ekspertizës ashtu dhe të mënyrës së zhvillimit të këtyre temave për Kontrolluesit dhe përpunuesit në vendin tonë.

Temat e mësipërme të zhvilluara në këtë Konferencë na u vunë në dispozicion në rrugë elektronike dhe nga ana jonë është organizuar sic përmendëm më lart puna për përkthimin e tyre dhe për përfitimin maksimal të kësaj eksperience ndërkombëtare të përparuar.



Gjithashtu, në datë 3 Nëntor 2009, në Madrid u organizua konferenca e autoriteteve të vendeve Frankofone, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të institucionit tonë. Në këtë aktivitet thuajse të gjithë vendet Frankofone prezantuan legjislacionin përkatës në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, projektet për të ardhmen në këtë drejtim, etj. Një theks i veçantë iu vu mbrojtjes së fëmijëve online.

Është e rëndësishme të pasqyrojmë se, ky aktivitet ishte paraprirë nga Anëtarësimi me të drejta te plota të institucionit tonë në Shoqatën Frankofone të Autoriteteve mbikqyrëse botërore.

Ndërsa në datë 4, 5 dhe 6 Nëntor në Madrid u organizua Konferenca ndërkombëtare e 31-të e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave. Sërish edhe në këtë aktivitet pjesëmarrja jonë shfrytëzoi mundësinë e përfitimit të eksperiencave të vendeve të ndryshme.

Kryesisht, ky organizim i rëndësishëm konsistonte në kontributin aktiv në përparimin e zhvillimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në balancën mes sigurisë dhe privatësisë, në parandalimin dhe reagimin lidhur me shkeljet e sigurisë (security breaches), në nxitjen e shoqërisë për të investuar lidhur me mbrojtjen e privatësisë, në njoftimin mbi shkeljet e sigurisë së të dhënave, etj. Konferenca synoi orientimin e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave drejt ngritjes dhe unifikimit në një kohë sa më të afërt të një sistemi rraportimi mbi shkeljet e konstatuara në privatësinë, në shoqërinë tonë të informacionit, etj.

Zhvillimet e arritura në këtë konferencë, eksperiencia e këtij aktiviteti, temat e rëndësishme të trajtuara, praktikat më të mira të përcjella në panelet përkatëse, pajisja me literaturë për pjesëmarrësit, për stafin e zyrës sonë ishte përfitim profesional dhe përkushtim në vazhdimësi.

Pikërisht këto e të tjera u prezantuan në mënyrë të përmbledhur në një seminar të brendshëm për të gjithë stafin e zyrës nga Drejtoria e Çështjeve Procedurale Ligjore e Marrëdhënieve me Jashtë, pranë institucionit tonë.



#### 4.1 Akreditime të mëtejshme

##### **Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave**

Institucioni i Komisionerit ka paraqitur zyrtarisht kërkesën për akreditimin në Konferencën e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, vendim i cili do të merret në Konferencën e Pranverës, më 29-30 Prill 2010 në Pragë. Kjo kërkesë iu paraqit Zyrës së Komisionerit Çek, e cila ka konfirmuar parashtrimin e kërkesës tonë pranë Komitetit të Akreditimit, bazuar në procedurat e përcaktuara në Udhëzimin për pranimin në këtë Konferencë, të miratuar në Konferencën e Roterdamit, më 23 Prill 2004. Anëtarësimi në këtë familje të madhe evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale do të jetë vlerë e shtuar dhe një nxitje për institucionin tonë, si në aspektin bashkëpunues me homologët evropiane për hartimin dhe zbatimin e politikave të përbashkëta për vendet anëtare, por edhe për gjetjen e strategjive për garantimin e privatësisë dhe të të dhënave personale në rastet e transferimit ndërkombëtar të këtyre të dhënave në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, të realizuar nga autoritetet tona të drejtësisë dhe atyre evropiane.

Ky angazhim vjen në momentin e duhur, pasi kuadri ligjor, teknologjia dhe teknikat e reja të miratuara në kuadrin e BE-së për të patur një bashkëpunim policor e gjyqësor ndërkombëtar eficient po zbatohen edhe në vendin tonë. Institucioni ynë, mirëpret dhe mbështet rritjen e efikasitetit në këtë drejtim përsa i përket luftës kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, por nga ana tjetër, duke patur të drejta të plota në këtë Konferencë dhe më pas në institucionet e tjera të saj në rang evropian, do përpiqet të garantojë dhe zbatojë, sipas standarteve evropiane, parimet e mbrojtjes së privatësisë dhe të të dhënave personale të individëve të përfshirë në këtë proces.

#### 4.2 Takime

Në kuadër të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale në zyrën e Komisionerit janë zhvilluar takime me përfaqësues të Misionit diplomatik Australian në Beograd, respektivisht Sekretarit të parë të kësaj Ambassade për migrimin si dhe me përfaqësues të Autoritetit Qëndror Anglez për shkëmbimin e dosjeve kriminale mes dy vendeve, me kërkesë të tyre.



## 5. Trajnimi i Stafit të Komisionerit

Një nga qëllimet kryesore të Institucionit të Komisionerit ka qenë rritja cilësore e kapaciteteve të stafit të saj, produktiviteti dhe arritja sa më shpejt e objektivave të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë shqiptare në drejtim të integritetit sa më të shpejtë në Bashkimin Europian. Për të bërë të mundur realizimin e këtyre objektivave është i domosdoshëm trajnimi i vazhdueshëm i stafit dhe njohja e praktikave më të mira të vendeve të huaja nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave dhe vizitave të ndryshme për të prekur më nga afër mënyrën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në këto vende.

Stafi i institucionit të Komisionerit është treguar mjaft aktiv për sa i përket përthithjes së eksperiencave të vendeve të huaja dhe trajnimit të tij, duke zhvilluar takime brenda dhe jashtë vendit me institucionet homologe dhe me ekspertë të huaj.

Përfaqësues të Komisionerit me datë 28 dhe 29 janar 2009 u përfshinë në një delegacion me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Integritetit, për të marrë pjesë në Seminarin e organizuar nga KE në Bruksel, mbi ecurinë e Autoriteteve Mbikëqyrëse të të Dhënave Personale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë organizim u shkëmbyen eksperiencia me këto vende si dhe u dhanë mendime dhe rekomandime nga ekspertë të KE për ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës Shqiptar, Komisionerit të të Dhënave Personale sipas rekomandimeve dhe direktivës të BE.

Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës pranë zyrës sonë asistoi eksperti i saj z. Graham Sutton, për dhjetë ditë 16-26 Shkurt, i cili punoi me qëllim trajnimi stafin e Institucionit të Komisionerit dhe personelin e Qendrës së të Dhënave pranë Policisë së Shtetit, duke dhënë kështu një eksperiencë të vlefshme për zbatimin me efikasitet të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në datat 10-19 Mars 2009 stafi ynë mori pjesë në 2 vizita studimore trajnuese të organizuara nga K.E., në Republikën e Çekisë dhe Portugalisë. Në këto vizita e rëndësishme ishte njohja dhe marrja e dokumentacionit të gjerë të veprimtarisë së tyre lidhur me publikimin e ligjit, format e ankimeve, procedurat e nisjes së hetim inspektimit, procesverbalet e investigimit, dokumentet provues, mënyrat e vënies së gjobave dhe





vjeljen e tyre, dhënien e mendimeve për ligjet që kanë të bëjnë me të dhënat personale, formën e vendimeve të Komisionerëve, etj.

Duhet theksuar dhe çmuar njëkohësisht asistenca e dhënë institucionit tonë nga muaji Maj 2009 deri në tetor 2009 nga Komisioneri i KE për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ish Komisioneri i Republikës së Çekisë. Asistenca konsistonte në organizimin e seminarëve të ndryshëm në ambjentet e punës dy herë në javë, referimet e temave kryesisht në paraqitjen e rasteve praktike dhe zgjidhjen e tyre në seminarët e organizuar nga stafi ynë në mbarë vendin si dhe në ndihmesën dhënë të gjithë drejtorive të autoritetit tonë në trajtimin e çështjeve për zbatimin e ligjit dhe hartimin e akteve nënligjore.

Në datat 7-8 Maj 2009, Komisioni Evropian nëpërmjet programit TAIEK, në bashkëpunim edhe me Akademinë Evropiane të Ligjit (ERA) mbështetur nga Ministria e Integritetit dhe Zyra e Komisionerit, organizoi në vendin tonë seminarin me temë *“Mbrojtja e të dhënave personale në kuadrin e bashkëpunimit policor dhe sistemit gjyqësor në çështjet penale”*. Në këtë seminar u përfaqësuam me prezantimin me temë *“Pasqyrë e legjislacionit egzistues kombëtar për mbrojtjen e të dhënave, posaçërsht në lidhje me bashkëpunimin polici – sistem gjyqësor në çështje penale”*, përmes së cilës u shtjellua gjerësisht baza ligjore egzistuese për mbrojtjen e të dhënave personale në këto sektorë përfshirë këtu edhe amendimet që i janë bërë kodit penal.

Për trajnimin thuajse të të gjithë stafit tonë, në datat 15-20 Qershor 2009 Zyra e Komisionerit zhvilloi një vizitë studimore në Agjencinë Kroate të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Megjithëse institucioni i ri në ngritjen e tij ofronte një eksperiencë të vyer në drejtim të nivelit të lartë të sigurisë së sistemit të intranetit.

Gjithashtu, në datat 27 dhe 28 Gusht 2009, me ftesë të Zyrës së Komisionerit Çek për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në ambjentet e këtij institucioni u zhvilluan takime trajnuese të drejtëpërdrejta të disa ekspertëve të institucionit tonë, të cilët ndoqën nga afër dhe në praktikë procedurat e ndjekura nga struktura kompetente e institucionit çek përsa i përket pëmbushjes së detyrimit për njoftimin e subjekteve kontrollues pranë autoritetit mbikqyrës.

Duke marrë në konsideratë praktikën disa vjeçare të ndjekur, konsolidimin e praktikës ligjore të pasqyruar në amendimet e ligjit, ngritjen dhe funksionimin e një programi kompjuterik të veçantë për menaxhimin e njoftimeve dhe regjistrimit *online* të subjekteve



kontrolluese, e ndërthurur kjo edhe me dispozitat e Ligjit tonë, kjo ekperiencë shërbeu më pas për hartimin dhe miratimin e kuadrit tonë nënligjor, për hartimin dhe zbatimin e një strategjie menaxhuese institucionale për ndjekjen dhe përmbushjen e detyrimit për njoftim dhe regjistrimin e subjekteve kontrolluese.

Po ashtu, trajnimi shërbeu dhe për ideimin dhe ngritjen e programit tonë kompjuterik për menaxhimin e këtyre procedurave administrative, pavarësisht faktit që programi ynë është shumë herë më i thjeshtë, duke marrë në konsideratë edhe pamundësinë financiare për të realizuar një program identik me programin çek. Në të ardhmen shpresojmë që të na alokohen fonde të mjaftueshme për ngritjen e një programi më të avancuar, përfruar me eksperiencën çeke ose të vendeve të tjera, i cili do të ishte në të mirë të të gjithë aktorëve të përfshirë. Gjatë këtij trajnimi u analizuan, shqyrtuan dhe u diskutuan zgjidhje të çështjeve konkrete të regjistrimit të subjekteve kontrollues, metoda të cilat po aplikohen sot nga struktura përgjegjëse e Zyrës së Komisionerit.

Një fushë tjetër e këtyre dy ditëve të trajnimit të stafit tonë ishte edhe implementimi i strategjive të veçanta të ndjekura nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për të sensibilizuar opinionin publik dhe për të garantuar një mirëfunksionim të Autoritetit Mbikqyrës”. Në harkun kohor të dy ditëve u zhvilluan biseda dhe debate trajnuese me Drejtoreshën e Departamentit të Shtypit pranë Komisionerit në të cilat u diskutua për eksperiencën çeke në këtë drejtim, përsa i përket strategjisë së komunikimit dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm.

Në këtë kuadër u pajisëm me informacion mbi fusha të cilat kishin të bënin me çështje të ndryshme të sensibilizimit të opinionit publik, botimin e një buletini për publikun e gjerë, organizimin e një konference shtypi çdo 3 muaj në të cilën bëhej transparente puna e Zyrës së Komisionerit Çek, praktika të cilat janë implementuar rast pas rasti nga zyra jonë dhe do të intensifikohen në vazhdim.

Një temë tepër interesante ishte ajo e zhvillimit të një projekti me fëmijë të shkollave të mesme të cilët merrnin pjesë në një konkurs të hapur pikturash me temë mbi privatësinë, çka është organizuar dhe ka rezultuar tepër pozitive, sikurse e parashtruam më lart.

Gjithashtu, në drejtim të forcimit dhe profesionalizimit të kapaciteteve të institucionit të Komisionerit janë zhvilluar dhe një sërë takimesh të tjera, e më egzaktësisht:



Në datat 1, 2 Dhjetor 2009 Institucioni ynë realizoi një vizitë studimore pranë Zyrës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Suedi. Si një ndër institucionet më me eksperiencë në këtë fushë i ngritur që prej vitit 1973, vazhdonte përsëri të vlerësonte edhe në ditët e sotme ndërgjegjësimin e subjekteve të të dhënave kryesisht lidhur me rrjetet sociale facebook, myspace, etj. Duke qenë një institucion qëndror funksionimin e tij në të gjithë Suedinë e mbështeste në përfaqësues të kontrolluesve (Data Protection Officers) të cilët trajnoheshin vazhdimisht nga ky autoritet. Nga një panoramë e gjërë që ky autoritet prezantoi në interes të punës sonë, rezultoi se ndër të tjera prej tyre ishte punuar shumë në drejtim të hartimit të akteve ligjore për sektorë të veçantë në fushën e të dhënave. Nga kjo vizite u morën një sërë materialesh për përgatitjen e akteve në vazhdim të institucionit tonë. Ky shkëmbim eksperience vazhdon edhe sot.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit dhe përfitimit të eksperiencës, Drejtorja e Hetim Inspektimit dhe një specialist i TI në datat 10-11 Dhjetor 2009 zhvilluan një vizitë studimore në Zyrën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Portugali. Gjatë kësaj vizite interes i veçantë iu kushtua pjesëmarrjes në një inspektim pranë Universitetit “INSTITUTO de ARTES VISUAISI DESIGN E MARKETING LISBONA”. Në këtë inspektim të përbashkët e rëndësishme ishte thithja e eksperiencës, njohja dhe marrja e dokumentacionit të gjerë të veprimtarisë së tyre lidhur me format e ankimeve, procedurat e nisjes së hetim inspektimit, proces-verbalet e investigimit, dokumentet provues, mënyrat e vënies së gjobave dhe vjeljen e tyre, dhënien e mendimeve për ligjet që kanë të bëjnë me të dhënat personale, formën e vendimeve të Komisionerëve, etj. Ndër të tjera përfaqësuesit e zyrës së komisionerit portugez i dorëzuan përfaqësuesve të institucionit tonë një dosje të plotë me të gjithë aktet e nevojshme për kryerjen e hetimit pranë kontrolluesve, praktikë të cilën tashmë ata e kishin të standartizuar dhe përdorur në të gjithë veprimtarinë e punës së tyre. Ky material do të shërbejë në investigimet që drejtorja përkatëse e institucionit do të realizojë në kontrollues të ndryshëm ashtu sikurse është shprehur dhe angazhuar në strategjinë për vitin 2010.

Në datat 14-17 Dhjetor 2009, zhvilluam një vizitë studimore në Zyrën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Slloveni. Kryesisht, eksperiencia që mundëm të përfitojmë ishte se, baza e aktivitetit nuk ishin ankesat por investigimet dhe inspektimet, të programuara dhe të befasishme, kryesisht për zbatimin e kërkesave të ligjit. Gjithashtu, nga ky autoritet vazhdimisht ndiqej ndërgjegjësim nëpërmjet materialeve të komisionerit për shumë sektorë të veçantë si dhe fletë palosjeve, informacione në gazetë, televizor, radio etj.



E rëndësishme ishte ngritja e intranetit me paisje bashkëkohore, me shumë vlera për Institucionin, Shtrirja e investigimit dhe Inspektimit dhe në organe të tilla si Policia, Gjykata, Prokuroria, Caktimi i një mënyre për marrjen e informacionit nga shtypi e media, si dhe;

Amendimi i ligjit në drejtim të shtimit të përcaktimeve lidhur me kategorinë e të dhënave si vëzhgimi me kamera, të dhënat biometrike, rrjetet sociale, caktimit tek Kontrolluesit të oficerit ndërlidhës me Komisionerin, etj.

Në këtë bashkëpunim institucioni u ftua për anëtarësim në shoqatën IT evropiane me qendër në Gjermani përmes specialistit IT, përfaqësim që u mirëprit nga shoqata gjermane dhe u realizua në mënyrë të menjëherëshme. Po kështu, në kuadër të përfitimit të eksperiencës në datat 21-22 Dhjetor 2009 nga një pjesë e gjerë e stafit tonë u realizua një vizitë studimore në Itali.

Duke marrë shkas nga eksperiencia dhe rëndësia që Autoriteti Italian ka në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kërkoi nga pala homologe njohjen me eksperiencën e tyre shumë vjeçare në fushën e hetim inspektimit, procedurave të njoftim regjistrimit si dhe të marrëdhënive me publikun. Gjatë kësaj vizite studimore pala shqiptare u mirëprit nga homologët e saj italianë ku pas një takimi me Presidentin e Kolegjit të Autoritetit Italian, rendin e ditës e ndoqi një prezantim i detajuar me shërbimet e mjeteve të informimit të publikut, pritjen e ankesave dhe kërkesave nga ana e drejtorisë së marrëdhënive me publikun, shërbimin e studimeve dhe dokumentacionit në lidhje me përditësimin e punonjësve të autoritetit me të rejat më të fundit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe redaktimin e raportit vjetor.

Në kuadrin e eksperiencës së përfituar për sa i përket risive të nxjerra nga ky sesion i takimit, po adaptojmë përshtatjen e institucionit në lidhje me funksionimin më të mirë të Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun duke përfshirë këtu ngritjen e bibliotekës në lidhje me publikimet më të rëndësishme botërore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kujdesjen e përkthimit të tyre në gjuhën shqipe.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i kësaj vizite ishte dhe pjesa për sa i përket procesit të njoftim regjistrimit ku eksperiencia Italiane tregonte për një evolim të madh teknologjik, që është marrë në konsideratë nga Drejtori i Regjistrimit dhe specialisti i IT-së. Një pjesë shumë të rëndësishme të vizitës e mbuloi seksioni i trajnimit në lidhje me procedurat e hetim inspektimit. Është për tu përmendur fakti se rasti italian na paraqiti një situatë unike në



panoramën evropiane për sa i përket këtyre procedurave. Autoriteti italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (i quajtur GARANTE) në ushtrimin e kompetencave të tij hetuese dhe investiguese bashkëpunonte me “Guardia di Finanza”. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, të rregulluar me ligj, kjo e fundit në çdo qytet të Italisë kishte një numër të caktuar specialistësh të cilët ishin në dispozicion të problematikës së “Mbrojtjes së të Dhënave Personale”. Në Romë operonte një skuadër prej 50 punonjësish, të cilët kryenin punën përgatitore në funksion të autoritetit të Garantes. Eksperiencia e shkëmbyer me departamentin e hetim inspektimit Italian solli pranë autoritetit tonë një sërë informacionesh të vyera në lidhje me këtë fushë të cilat do të jenë shumë të vlefshme për punën gjatë zhvillimit të veprimtarisë sonë në vitet në vijim.

Është e rëndësishme të theksohet se nga ana jonë u vlerësua për tu marrë në konsideratë eksperiencia italiane në draftimin e legjislacionit në këtë fushë nëpërmjet “Kodit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale” tashmë i miratuar që prej vitit 2003 në përmbajtje të të cilit ishin grupuar amendimet, azhornimet, kodet e sjelljes dhe rregulloret e ndryshme vit pas viti nga krijimi i autoritetit të Garantes në 1996, i cili aktualisht është duke u përkthyer prej nesh.

Në fund të kësaj vizite në cilësinë e titullares së institucionit së bashku me këshilltarin u pritëm në një mbledhje të Kolegjit të Autoritetit Italian nga Presidenti i saj, anëtarët e tjerë të Këshillit si dhe Sekretari i Përgjithshëm të cilët ofruan bashkëpunim të plotë me autoritetin tonë si dhe një marrëveshje binjakëzimi ndërmjet institucioneve tona.

Në kuadrin e këtij bashkëpunimi të mëtejshëm me Autoritetin Italian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, institucioni ynë ka mbajtur kontakte të vazhdueshme, duke kërkuar asistencë në lidhje me veprimtarinë ligjore në sektorë të veçantë.

## **6. Strategjia për vitin 2010**

Përgatitja e Strategjisë institucionale për vitin 2010, e prezantuar në ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, synon të nxisë ndërgjegjesimin dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke bashkëpunuar kështu me të gjithë aktorët vendas dhe ata ndërkombëtarë.



Gjithashtu, në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie do të duhet që të gjitha institucionet publike dhe private të bëjnë përpjekje për të zbatuar procedurat dhe parimet për mbrojtjen e të dhënave në funksionimin e tyre.

Strategjia e vitit 2010 konsideron një tjetër aktor në nivel kombëtar të rëndësishëm publikun e gjerë. Për këtë qëllim në këtë dokument evidentohet dhe kërkohet rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve si një kontribut i rëndësishëm për zbatimin e Mbrojtjes së të Dhënave.

Po ashtu, Strategjia synon dhe kërkon në nivel ndërkombëtar, bashkëpunim dhe mbështetje nga aktorë si BE, OSBE dhe Këshilli i Evropës në mënyrë që të zbatohet kuadrin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky dokument i rëndësishëm për vitin 2010 shtrin objektivat e tij në tri fusha parësore, e konkretisht në:

- **Zbatimin e mbrojtjes së të dhënave personale,**
- **Prezantimin e parimit të Teknologjive që rrisin Privatësinë si dhe në,**
- **Përmirësimin e organizimit të KMDP.**

Për të realizuar këto objektiva, synohet që nga ana e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të hartohen kodet e sjelljes, udhëzues për sektorë të veçantë, synohet të kryhen investigime, inspektime në kontrollues të ndryshëm, të përparohet me qasjet ndërkombëtare, të stimulohet tek sektorët privatë dhe publikë parimi i Teknologjive që Rrisin Privatësinë (TRrP) për të siguruar përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale si dhe të rriten kapacitetet e stafit duke përmirësuar kapacitetet e TI në KMDP dhe përmirësimet në strukturën e tij në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në, procesit të liberalizimit të vizave dhe integritit tonë në BE.

## **7. Infrastrukturë dhe Mbështetje Financiare**

Në kuadër të mbështetjes së dhënë nga qeveria shqiptare, dëshiroj të vë në dukje angazhimin maksimal dhe të vazhdueshëm të saj, i cili u konkretizua me pajisjen me zyra për institucionin në bazë të VKM nr. 217, datë 2.02.2009 *“Për dhënien në përdorim*



*Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të një pjese të ish-ndërtesës së Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve” duke u ndjekur më pas nga ana e institucionit tonë me paisjen e tyre me mjetet e nevojshme të punës.*

Për organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni paraprakisht u ndërmorrën një sërë hapash të rëndësishëm:

- U finalizua ndarja e buxhetit për vitet 2008 dhe 2009, për fillimin e funksionimit të Institucionit;
- U realizua procedura e prokurimit të pajisjeve informatike;
- U realizua procedura e prokurimit të mobilimit të zyrave;

Si rrjedhojë e përfundimit të këtyre procedurave u arrit paisja e një pjese të stafit me kompjutera, printera, fotokopje dhe me pajisje të tjera logjistike.

Megjithatë, në këtë kuadër cilësohet si tepër e rëndësishme mbështetja financiare edhe e institucioneve të huaja, si Këshilli i Evropës, OCSE përmes projekteve të realizuara në vitin 2009 siç kemi përmendur më sipër.

Gjithashtu, nga ana jonë vlerësohet edhe ndihma e dhënë nga Komisioni Evropian nëpërmjet programeve të miratuara, IPA- 2009, për të bërë të mundur plotësimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të institucionit tonë, kryesisht në asistencë me ekspertizë të fushës në të ardhmen e afërt.

Po ashtu, në mënyrë progresive janë hartuar planet mujore e vjetore për realizimin e detyrave më të rëndësishme për të cilat është bërë kujdes në kërkesë llogarinë e plotësimit të tyre.

Në përfundim,

Të nderuar zonja e zotërinj Deputetë,

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shpreh angazhimin e përkushtimin maksimal për zbatimin e prioriteteve të përcaktuara në strategjinë institucionale të vitit 2010, tashmë dokument i publikuar në faqen tonë zyrtare.